



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësinë Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	758
Nr. i fazeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	25/06/2020
Hyrëse PRISHTINE/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Nr. 69/2020
Datë: 25/06/2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, i plotësuar dhe ndryshuar, me qëllim të zbatimit të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për luftimin e pandemisë me COVID 19, Ministria e Ministrisë së Financave merr këtë:

VENDIM

1. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin e deklarimeve në KKRF, për pasivitet të vitit paraprak afarist për shoqëritë tregtare, të cilat gjatë vitit afarist nuk ka pasur aktivitet afarist dhe nuk kanë regjistruar asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet në librat kontabël, sipas nenit 18, paragrafi 4, të Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
2. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 për dorëzim në KKRF për publikim i pasqyrave vjetore financiare, përkatësisht pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara, raportin e menaxhmentit, raportin e konsoliduar të menaxhmentit dhe raportin e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, përkatësisht raportin e auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare, sipas nenit 18 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
3. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 për dorëzim në KKRF i pasqyrave financiare vjetore respektivisht pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e rishikimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare, sipas nenit 18, paragrafi 2, të Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

4. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituara në pajtim me SNA-të, në KKRF dhe publikimi i tyre, si dhe dorëzimi i tyre në Ministrinë përkatëse për tregti dhe industri, sipas nenit 17, paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

5. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe në KKRF i pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shtesë lidhur me vitin paraprak kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera, sipas nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

6. Shtyhet afati deri më 15 gusht 2020 i raportimit vjetor të Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.03/2014 për Procedurat e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë së Punës së Shoqatave Profesionale të Licencuara, Firmave të Auditimit dhe Auditorëve Ligjor.

7. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me shpalljen e gjendjes së Pandemisë si pasojë e virusit Covid-19, Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, ndërmoi masat kufizuese të lirisë së lëvizjes së lirë për të parandaluar përhapjen e mëtejme të virusit.

Ministria e Financave (në atë kohë Ministria e Financave dhe Transfereve), bazuar në situatën e krijuar, me datë 18.03.20 nxori vendimin Nr.25/2020, mbi shtyrjen e afatit të dorëzimit të pasqyrave financiare individuale dhe të konsoliduara deri me datë 30.06.2020.

Si pasojë e vendimit të datës 18.03.2020, në Këshillin për Kontabilitet dhe Raportim Financiar (tutje KKRF) deri më datë 12.06.2020 janë dorëzuar vetëm 0.94% të raporteve financiare, gjë që dëshmon që vendimi ka qenë shumë i mirëpritur nga shoqëritë tregtare.

Edhe pse masat kufizuese tani më janë relaksuar, gjendja e pandemisë ende po vazhdon. Numri i personave të infektuar me virus po rritet vazhdimisht.

Ministria e Financave ka pranuar kërkesë nga KKRF për shtyrjen e afatit deri më datën 15 gusht 2020, me arsyetimin se ka mbi 45 mijë raporte financiare që duhet të dorëzohen nga shoqëritë tregtare deri më datë 30.06.2020 dhe kapacitetet e KKRF janë shumë të limituar për të proceduar

me të gjitha kërkesat e grumbulluara. Po ashtu shtyrja e afatit është kërkuar edhe nga komuniteti i biznesit për tu lënë më shumë hapësirë në dorëzimin e raporteve financiare, për shkak të situatës së krijuar.

Shtyrja e afatit për dorëzimin e raporteve financiare për periudhën deri me 15 gusht 2020, është i një rëndësie të veçantë, për disiplinën e përgjithshme të raportimit financiar në Republikën e Kosovës. Kjo do të ndikoj pozitivisht në aspektin e edukimit të shoqërive tregtare, mbi përgatitjen e pasqyrave financiare për nevojat e veta dhe për nevojat e përgjithshme, me interes të veçantë të institucioneve financiare, kreditorëve, investitorëve potencial si dhe institucioneve qeveritare.

Bazuar nga kjo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Hjkmete Bajrami**

Ministre e Financave

Iu dërgohet:

- Këshillit Kosovar për Raportim Financiar;
- Divizionit Administrativ i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar; dhe
- Arkivit të Ministrisë.